

SIMBOLIZIMI ILIR DHE MOTIVET ZOOMORFE NË VESHJEN E REKËS SË EPËRME

Edibe SELIMI-OSMANI

Përmbledhje

Punimi trajton disa pjesë të veshjes dhe aksesorë që kanë të bëjnë me motivet që nga lashtësia deri në ditët tona. Në simbolikën Ilire shpezët shtegtarë përgjithësisht kanë të bëjnë me simbolin solar. Vetë shpezët simbolizojnë fuqinë e dritës dhe luftojnë kundër fuqisë të erësirës htonike. Simboli i Diellit, por dhe shumë motive të tjera të lidhura me mite e besime të lashta të Ilirët, përdoren edhe sot nëpër masa të gjëra. Përveç asaj ata i gjejmë edhe në ornamentikën e veshjes popullore të Rekës së Epërme.

Ormamentika e saj e bollshme e shprehur artistikisht, shton domosdoshmërishtë funksionin estetik në veshjen e kësaj krahine, por, motivet tash më e kanë humbur kuptimin mitologjik të tyre. Aktualisht si funksion të vetëm të tyre kanë atë estetik, duke u përdorur vetëm si motive zbukurimi.

Si objekt studimi kemi veçuar motivet : e bletës, Diellit, gjelit, pëllumbit, palloit, dhe peshkut.

Fjalë kyçe: etnogjeneza, analogji, motive, trashëgimi.

Dekoracioni plastik i aplikuar në stelat e varreve që sqaron element të artit që kishte popullata e asaj kohe, janë veshjet tradicionale të popullsisë si *këmisha, shamia, plisi, opingat, tallagani, stolitë e veshjes* që e dokumenton antroponimia e mbishkrimeve në buste, se kemi të bëjnë me një popullatë autoktone Ilire me prejardhje nga fshatrat e krahinave shqiptare, në to zënë vend motivet solare antropomorfe, zoomorfe dhe flurale, që kanë analogji me simbolet e gjetura në nekropolet e qyteteve antike të Maqedonisë së veriut. (E. Dobruna, Prishtin; 2016).

Po të bëjmë një krahasim me aplikacionet dhe motivet që përdoren në veshjen popullore, ata dëshmojnë se po këto motive, edhe sot i gjejmë në kostumin popullor të femrave në Rekën e Epërme. Në mesin e katër maskave funerale të gjetura në Nekropolin e Trebenishtës, dallon edhe ajo me simbolin e **bletës**.

Simbolet dhe motivet solare të aplikuara në maskat funerale si dhe te aksesorët, bindshëm flasin se kemi të bëjmë me simbole vendase, pa asnjë dyshim se pasanikët e varrosur në Nekropolin e Trebenishtës, i takojnë bashkësisë së fiseve, *Dasaretëve* të dëshmuara në historinë e lashtë dhe burime nga Lihnida. (Sokolovska, Bitrakova, 1997 Ohër)



Foto.maska me bletë

Nga *Mitologjia e lashtë*, Bleta konsiderohet si një insekt i jashtëzakonshëm dhe misterioz por që është përdorur në sensin pozitiv (Qazimi, 2008: 27). Ajo ka qenë qendra e besimeve popullore të tregimeve mitike dhe në devocionin e pakufishëm religjioz. Zeusi, babai mitologjik i zotrave dhe njerëzve kur ishte i vogël është ushqyer krahas qumështit të "*dhijsë amaltea*" dhe me mjaltë. Sipas legjendave të ndryshme që në antikitet bletët janë simbol i mbijetesës dhe i ringjalljes.

Në njërën nga maskat, konkretisht në atë të Nekropolit të Varrit.1 *Trebenishka*, mbi rrënjën e hundës ka një paraqitje plastike të një blete. Nga erdhi bleta pikërisht mbi një maskë prej ari dhe padyshim që i përkiste një rangu më të lartë njerëzish në atë kohë në komunitet!

(Vasillka, Shkup 2022) Disa studiues shkruajnë se bleta si simbol është sjellë nga Egjipti, ku përfaqëson një nga simbolet e para mbretërore dhe në sistemin e ritit funeral vizualizon shpirtin e të ndjerit hyjnor, d.m.th. simbolizon fuqinë e tij të madhe. Por bleta si simbol gjendet në shumë kultura dhe qytetërime para dhe pas Nekropolit *Trebenishtë*.

Çulka me simbolin e bletës



Në veshjen popullore shqiptare *çulkat*, janë pjesë e dytë e të mbathurave ku dominon motivi i bletës. Ky element edhe sot përgatitet dhe mbahet nga gratë që do të thotë se motivi i bletës është një vazhdimësi e trashëguar nga të parët.

Gjatë ekspeditave të bëra po në këtë krahinë, në vitet e 90' në fshatin Sencë, në kremen *Shën Mëria e Vogël*, ishim pjesëmarrës në familjet krishtere atje ku kishin koshere bletësh me shumicë. Amvisa sa zbardhte dita sjellte *ujë të fjetun* nga kisha e fshatit. Më parë ajo i ka zbukuruar kosheret me lule të stinës. Mbi kosheret ajo vendos nga një kore petë të lyer me mjaltë. Me *ujin e fjetur*, stërpik kosheret me degë hithi dhe busulegu duke përsëritur disa herë me zë fjalët "*U shtofshin gjetët! Gjetët si hithi, mjalti si ujt!*" *Gjetët si hithi, mjalti si ujt!*... (Edibe. *Rite e besime...* 1997)

Po kjo kremte dëshmon se janë kultivuar bletët.

Maska me simbolin solar Diellin

Për karakterin autokton të simboleve solare në trevat Ilire na dëshmojnë një varg faktesh. Nga sistemi i simbolikës pellazgo-ilire mësojmë se përveç simbolikës solare, motivet ishin personifikim i Diellit, pastaj kishin domethënie totemike, sarkale e tjerë. Si Dielli, Hëna, Yjet dhe shumë motive të tjera pellazgo-ilire, me mite e besime të lashta, ata përdoren edhe sot nëpër masa të gjera (A.Gjergji, 1979:Tiranë). Është me rëndësi të përmendet, se në mitologjinë ilire Dielli adhurohej si Perëndi. Ndërsa te grekët antikë, kulti i tij nuk kishte ndonjë rëndësi, siç pohonte vetë Platoni. Diellin e kanë adhuruar si hyjni, kulte me origjinë *Ilire*. Në mitologjinë shqiptare edhe sot ai zë një vend të rëndësishëm, siç vë në dukje edhe albanologu gjerman M. Lamberg (Grup autoresh 1970: 374).

Një dëshmi tjetër me rëndësi për kultin e **Diellit** ndër shqiptarët është tatuazhi. Gjatë ekspeditave të bëra në fshatin Radomir-Kalaja e Dodës, në Shqipëri,(Maj 2016) telakja në prezencën tonë me ndihmën e asketit dekoron me këna fytyrën e vajzës nuse, me kujdes bën motivin e gjysmëhënës midis vetullave, i radhitën xixat përreth simbolit të hënës, që simbolizojnë yjet. Me këna bën motive rrethore në mes të ballit dhe mbi mollëzat e faqeve. Motivet zakonisht ruajnë distanca të baraslarguara nga njëra-tjetra. Të gjitha këto zbukurime tatuazhi janë një lloj maske në fytyrë, ku vajza nuse kalon nga jeta e vajzërisë në atë të nusërisë. /foto.5/



Mendojmë se këto janë mbetjet e sotme ballkanike, të cilat janë karakteristike e kulturës së një populli. Me këto vlerësohet se janë ruajtur të gjalla edhe sot gjurmët e kulturës pellazgo-ilire. Zbukurimet me këna, ato rrethore të ballit dhe mbi mollëzat e faqeve simbolizojnë diellin. Edhe Andromaqi Gjergji, thotë se motivet rrethore (motivet solare), kanë qenë të lidhura me mite e besime të lashta. Por ky kuptim fillestar i tyre ka humbur me kohë dhe ato kanë mbetur tashmë thjeshtë si motive dekoruese (Gjergji, 1979: 48).

Motivi i gjelit



Si motiv zbukurues është përdorur në veshjen popullore edhe motivi i gjelit i përdorur në çorapët e dhëndërisë në fshtrat e krahinës në fjalë . Ndërsa janë mjaft të përhapura unazat e floririt me monedhë gjeli që i bartin femrat në kombinim me veshjen popullore të kësaj zone.Figurën e gjelit e ndeshim në formë të varseve të vogla prej bronzi,pra si amuletë. Më se e besueshme është se të gjitha këto figurina në sytë e tyre të cilët e bartin, kanë formuar bindje se do të mbrohen nga e keqja.(A.Stipçeviq.1983 Prishtinë)

Popujt e lashtë gjelit ia kanë mveshur vetitë që me këndimin në mëngjes t'i largojnë demonët e natës, prandaj edhe për shkak të kësaj kanë konsideruar se shembëlltyra e tij mund të shfrytëzohet si apotropion me të cilën njeriu mund të mbrohet jo vetëm nga demonët e natës,por edhe nga të këqijat tjera. Për shkak të këtyre besimeve edhe shumë popuj të tjerë i kanë bartur figurat e gjelit si amuleta¹³¹.(F.Cumont,Mithra,2001)

Nga gërmimet arkeologjike dhe studimet e viteve 1953/54, Vlladimir Lahtovi dhe J.Kostelic ,në Nekropolin e Trebenishtës, shkruajnë se përveç maskave gjenden edhe aksesore dhe varëse të ndryshme me simbolin e gjelit.Lahtovi dhe J. Kostelic duke e studiuar në kompleks kulturën e Trebenishtës,vijnë në përfundim se kjo kulturë nuk është as greke e as edhe ndonjë kulturë iliro-greke,ajo është kulturë Ilire dhe bartësit e saj janë fiset Ilire jugore,të cilat kryesisht populluan hapësirën e shtetit maqedonass.

Vlenë të theksohet se edhe amuletat e njohura me simbolin e gjelit të gjetura në lokalitetin antik të Bargallës, në afërsi të qytetit antik Astibo-Shtip,janë po të këtij antikiteti. Këto amuleta gjenden në Muzeun arkeologjik të Shtipit. (I.Nikulçiq,1999 Shkup)

Motivi i Pëllumbit



Pëllumbi ,dallëndyshja me kuptimin e udhës së diellit në botën tonë reale dhe në botën tjetër është përdorur edhe si motiv që zen vend të rëndësishëm në veshjen popullore të femrës. Mbështjellaku në foto dhe çorapët e femrave janë me motivin e pëllumbit të stilizuar . Kjo është një dëshmi e fuqishme se kemi të bëjmë me motive të lashta që e trashëguam deri në ditët tona.

¹³¹ F.Cumont , Textes et monuments relatif auz mysteres de Mithra ,I,fq.210.
Shif më gjërësisht: A.Stipçeviq, *Simbolet e kultit te Ilirët*, faq.68-69

Si ornamentet e zbkuruara ashtu edhe (amuletet në formë pëllumbi po me këtë shpezë të gjetura në Nekropolin e Prilepit (I. Mikulçiq, Shkup 1999) në mënyrë të çuditshme gjasojnë me motivet e pëllumbave të qendisura në disa pjesë të veshjes. Për të gjitha këto elemente ne gjejmë ngjajshmëri të drejtpërdrejtë edhe në fragmentin krehër kocke me motive zoomorfe të gjetura në qytetin antik Heraklea Lynceestis. (Fanula, Sarajevë 1969) Ky eksponat gjendet në Muzeun e Manastirit.(Anica,Shkup 2005)

Sipas legjendës, Apolloni i shenjtë në stinën e dimrit ka udhëtuar në veri për ta sjellë pranverën, dritën dhe ngrohtësinë. Karrocën e tij e kanë tërhequr zogjtë shtegtarë që simbolizojnë diellin.(S.Osvallt,Beograd 1979)

Shpendët moçalike do t'i ndeshim shpesh vetëm në fillim të shekullit VIII dhe pikërisht në viset jugore të Ilirinsë,në trevën e grupit kulturor të Trebenishtës në Maqedoni e në Shqipëri.(Stipçeviq,Prishtinë 1983)

Motive me Palloin

Siç kemi përmendur edhe më lartë,në simbolikën Ilire, shpezët shtegtarë në përgjithësi kanë të bëjnë me simbolet solare. Vetë shpezët simbolizojnë fuqinë e dritës që luftojnë kundër fuqive të erësirës htonike . Si dielli dhe shumë motive të tjera me mite e besime të lashta që përdoren edhe sot nëpër masa të gjëra i hasim në ornamentikën e veshjes popullore të shqiparëve por, edhe te popujt tjerë.

Edhe *palloi*, paraqitet botë më vete.Simbolika dhe domethënia e motiveve të aplikuara në këtë veshje kanë një domethënie të veçantë. Vlerat artistike të kësaj veshjeje kombëtare janë të lidhura ngushtë me një varg elementesh dekoracioni si ngjyrat,ornamentet, procesi i endjes,qëndisjes së motiveve e tjerë.



Motivi me *palloin*, në veshjen popullore të krahinës në fjalë është mjaft i dendur dhe zë vendin kryesor më së shumti te elementet si : mbështjellaku, çorapët dhe shamia e kokës. Ky motiv simbolizon gjithësinë, sepse në bishtin e zhvilluar të tij i grumbullon të gjitha ngjyrat.(Edibe,2012 Tetovë)

Te Ilirët, por edhe ndër popuj të tjerë, shpjegohet si simbol solar ngaqë para së gjithash zhvillon dhe hap bishtin e vet të gjatë në formë rrethi të plotë. Sipas shpjegimeve në Enciklopedinë e Kuperit, paraqet edhe simbolin natyror të Yjesisë Qiellore, prandaj përshkuhet si Apotheoza e pavekshmërisë.

Po këtë motiv e gjejmë të aplikuar në mozaikun e dyshemesë të Heraclea Lyncestis. (Kostadin,Prilep,1976)



Arkeologu Dr.Skënder Anamali,shkruan:”Prania e kulturës arbërore në zonën përreth liqenit të Ohrit, është krejtësishtë e kuptueshme dhe e shpjgueshme. Ajo në lashtësi i takonte fisit ilir të *Dasaretëve*. Si e tillë ajo ka qenë përfshirë në trevën e banuar nga Ilirët, pasardhës të të cilëve kanë qenë arbërit” . Ekzistojnë të dhëna tjera për Ohrin, emri i të cilit sipas Tomashekut, I. Ivanovit,L.Maletičit e St.Mlladenovit, buron nga emri Lychnidos, emri antik i liqenit dhe i qytetit, i banuar nga fisi Ilir i *Dasaretai-ve*.) Edhe motivi i palloit ka të bëjë me një kulturë ilire.

Motivi i peshkut

Simbolika e Peshkut lidhet me atë të Nënës së Madhe.Peshku, është simbol i vdekjes, por edhe jetës në jetën e amshueshme. Edhe pse ka patur funksion dekorativ peshku ka kuptim lunar te shumë popuj dhe na bën të mendojmë se kemi të bëjmë me një tip ballkanik me variante lokale. Motivi i peshkut në mbështjellakun e vajzës paramartesore dhe nuskat e shumta që ndeshen shpesh në veshjen popullore të femrave në fshatrat e kësaj krahine, siç duket fillesën e kanë që në kulturën ilire dhe simbolizojnë njëkohësisht edhe pjellshmërinë.

Në Nekropolin e Prilepit, në varinn nr.4 përveç ekspozateve tjera janë zbuluar edhe tre fragmente enësh ,gotë qelqi, pjatë dhe lugë bonzi. Në pjesën e brendshme të lugës është figura e peshkut. Enë të ngjajshme dhe me të njëjtat forma janë gjetur edhe në Nekropollin e Emonës.(J.Chevalier-(A.Gheerbrant,Zagreb 1989).

Përfundim

Sipas dëshmimeve arkeologjike si dhe studiuesve të njohur, një ndër to është edhe Sokolova, që shkruan:”Deri më tani janë shprehur mendime të ndryshme në lidhje me origjinën etnike të të vdekurve nga varret e Trebenishtës. Por, hulumtimet e fundit shkencore mbi bazat e disa të dhënave të shpjguara ,kanë dalë hipoteza se aristokracia e Trebenishtës, ishte me origjinë **Paeoniane** (*Pajone*)

Sot në dobi të kësaj kulture, flasin ekspozatat e rralla arkeologjike dhe etnografike të Muzeut privat në fshatit Livadhi të Strugës, pronë e dr.prof.Nebi Dervishit,(historin), i cili duke çmuar vlerat e larta kulturore të shqiptarëve,pasuroi Muzeun me mjete nga buxheti familjarë. Ekspozatat e ekspozuara të këtij Muzeu, në të ardhmen do të jenë në shërbim të arkeologëve,etnologëve për një studim më të hollësishëm. Gjetjet e ekspozuara janë kryesisht vendase të regjionit për të cilin bëhet fjalë.

Edhe pse Nekropoli i Trebenishtës, trajtohet kryesisht si lokalitet I njohur arkaik, në mungesë të fondeve, gjatë tridhjetë viteve të fundit nuk është bërë asnjë hulumtim nga institucionet përkatëse.

15.12.2022, Tetovë

Literaturë e shfletuar

- [1]. Bido, Agim, *Arti popullor në veshje e tekstile*, Tiranë 1991
- [2]. F. Cumont, *Textes et monuments relatifs aux mystères de Mithra*, I, fq. 210. Shif më gjërësisht A. Stipçeviç *Simbolet e kultit të Ilirët*.
- [3]. Ferri, Naser, *Mythologia viva Mitologjia e gjallë*, Instituti Albanologjik Prishtinë 2012.
- [4]. Gordana Tomasheviç, Manastiri 1966, faq. 16-24.
- [5]. J. Chevalier-A. Gheerbrant, *Rječnik simbola*, NZ Matica Hrvatske, Zagreb 1989.
- [6]. Kereski, Kostadin, *Северозападна некропола на Вилата Рустинка во Пеитерица кај Прилеп*. *Macedoniae acta archaeologica*, Prilep, 1976.
- [7]. Osmani Selimi-Edibe, *Rite e besime popullore në viset e Tetovës dhe Gostivarit*, Shkup 1997.
- [8]. Osmani-Selimi, Edibe, *Veshja autoktone e femrave të Rekës së Epërme Authentic clothing of women from Reka e Epërme*, Arbëria Design, Tetovë 2012.
- [9]. Salihu-Dobruna Exhlale *Saxa loquntur – Gurët flasin*, Prishtinë 2016
- [10]. Sokolovska. Bitrakova. 1997, *Етничките носители на Требенишката некропола*, Shkup, Ohër 1997
- [11]. Stipçeveq, Aleksandër, *Ilirët, historia jeta kultura* Rilindja Prishtinë 1980
- [12]. Stipçeveq, Aleksandër, *Simbolet e kultit të Ilirët* Rilindja Prishtinë 1983
- [13]. Димитровска, Василка магистаер по археологија *Златната маска од Требениште и македонската пчела Apis mellifera macedonica /arheološki dnevnik avgust 6 2022 автор,*
- [14]. Микулчиќ, Иван, *Антички градови во Македонија*, libri A8 botoi Akademia Maqedone e Shkencës dhe Artit, Shkup 1999.